



01-979



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-86996/21 dt. 18.05.2021, të pronareve Marash Krasniqi dhe Faton Jashanica nga Prishtina, dhe investitorit ”Pozhego Brothers” sh.p.k., me seli në Prishtinë, dhe me përfaqësues Qemajl Pozhegu nga Prishtina, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht ndërtesën “B2”, ndërtuar në kuadër të bllokut urbanistik “b-05”, të nëntërësisë urbane “B-1”, të tërësisë urbane “B”, të Planit Rregullues “Muhaxhirët”, në rr. “Bedri Shala”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, në procedurë administrative, me datë 13.07.2021, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET Marash Krasniqi dhe Faton Jashanica nga Prishtina, dhe investitorit ”Pozhego Brothers” sh.p.k., me seli në Prishtinë, dhe me përfaqësues Qemajl Pozhegu nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-86996/21 dt.18.05.2021, përdorimi i ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht ndërtesën “B2” me etazhitet 2B+S+P+10 e ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-641/17 dt. 14.06.2017, në parcelën kadastrale nr. 10146-1 (produkt i bashkimit të parcelave kadastrale me nr. 7385-2, 7385-3 dhe 7385-4), e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71914059-10146-1, ZK Prishtinë, konkretisht në kuadër të bllokut urbanistik “b-05”, të nëntërësisë urbane “B-1”, të tërësisë urbane “B”, të Planit Rregullues “Muhaxhirët” në Prishtinë.

II. Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Bedri Shala” ku kanë dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numrat: 68, 70, 72, në Prishtinë, dhe e njejta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njësive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

VI. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 6 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Pronareve Marash Krasniqi dhe Faton Jashanica nga Prishtina, me investitor ”Pozhego Brothers” sh.p.k., me seli në Prishtinë, dhe me përfaqësues Qemajl Pozhegu nga Prishtina, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-86996/21 dt.18.05.2021, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën afariste & banesore, përkatësisht ndërtesën “B2” me etazhitet 2B+S+P+10 e ndërtuar në kuadër të bllokut urbanistik “b-05”, të nëntërësisë urbane “B-1”, të tërësisë urbane “B”, të Planit Rregullues “Muhaxhirët” në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 10146-1 (produkt i bashkimit të parcelave kadastrale me nr. 7385-2, 7385-3 dhe 7385-4), ZK Prishtinë, ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-641/17 dt. 14.06.2017, Vendimit për plotësimin dhe ndryshimin e

86037/19 dt. 29.09.2020, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë 09 Nr. 391/02-198435/20 dt. 11.05.2021, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizmit, Raportet e Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimin të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 6 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Inspektimi i sigurisë nga zjarri; Fotografitë gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Krenare Kadriu; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Rexhep Saliu; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Violeta Hoxha; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Asmir Hamdi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Korab Lushta; Raportin e përfundimit të punëve të sigurisë nga zjarri, nga mbikqyrësi Arban Shala; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Burim Halilaj me nr. të licensës 195;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, si dhe Raportin e Inspektimit Final konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MEA-ja.

I dorëzohet: Kërkesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-86996/21 DT. 13.07.2021



Zyrtarja,
Bahtije Vllasaliu

B. Vllasaliu

U.D. Udhëheqëse e Sektorit,
Mimoza Berisha Prestreshi

Drejtori,
Ardian Olluri



